



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr.176/2023
Datë: 06.10.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh neni 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe pikën 8 (tetë) të Shtojcës 1 (një) të Rregullores NR. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor, Rregulloren NR. 11/2022 Për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Apropohet rekomandimi me numër të protokollit 5100/2023 i datës 06.10.2023 i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave - propozimeve të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme të Aseteve apo përmbajtje me forma të shprehjes kulturorë të cilat mund të jenë pjesë përbërëse potenciale të Trashëgimisë Kulturorë (në tekstin e mëtejme Komisioni Profesional Shqyrtues).

2.Lista e aprovuar si në pikën një (1) të këtij Vendimi, përfshin 23 (njëzetë e tre) asete të trashëgimisë kulturorë si në vijim:

1. Kulla e Duhanit “Adem Zajmi” - Pejë;
2. Ndërtesa e lokalit “Panda” - Pejë;
3. Kulla e Bekë Sylë Millakut - Ujmirë;
4. Kulla e Gjon Mark Çunit, Dresnik – Klinë;
5. Mulliri i Isuf Halilit - Përtoq i epërm;
6. Kulla e Nue Jakut - Videjë, Klinë;
7. Shtëpia dhe ahri i familjes Muniku - Prizren;
8. Shtëpia e familjes Tupeci - Prizren;
9. Shkolla e vjetër e fshatit Mushtisht - Suharekë;
10. Shtëpi banimi Izet Makolli - Marec, Prishtinë;
11. Ish Spitali Ushtarak Gradicë - Drenas;
12. Përmendorja e Minatorëve - Mitrovicë;

13. Ish Banoksi - Mitorovicë;
14. Oda e Rrahim Igrishtës -Selac;
15. Mulliri i Rrahim Igrishtës -Selac;
16. Kisha e Rekës - Fshati Koprivë, Mitrovicë;
17. Varri i Don Mikel Tarabulluzit - Fshati Letnicë, Viti;
18. Xhamia e Sfirçës - Dardanë;
19. Kulla e Hasanit - Kulla e Rambujesë, Kaçanik;
20. Shtëpia e Agim Luzhës - Begracë, Kaçanik;
21. Xhamia e vjetër Komogllave – Ferizaj;
22. Afreskat e Stibadium-it Triclinium - it - Dresnik;
23. Guri i Nanës Pashkë.

3. Këtij Vendimi i bashkëngjitet edhe Lista origjinale e cila konsiderohet pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Komunave përkatëse;
- Inspektoratit për Trashëgimi Kulturorë;
- Departamentit për Trashëgimi Kulturorë;
- Instrukcioneve të Trashëgimisë Kulturorë;
- QRTK - ve përkatëse;
- Agjencionit Kadastral të Kosovës
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS.

